

VENDIM
Nr. 2, datë 27.7.2026

**PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT,
PËR T’U PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T’I PROPOZOHET KUVENDIT
TË SHQIPËRISË, PËR T’U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË AUTORITETIN E KONKURRENCËS**

Pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë, nr. 2982 prot., datë 3.7.2026, se mandati 5-vjeçar i zonjës Rezana Konomi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 14.10.2026, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Hapjen e procesit për çdo të interesuar që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë me propozim të Presidentit të Republikës.
2. Shpallja e këtij procesi dhe publikimi sipas tekstit bashkëlidhur të bëhet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe në mjetet e informimit publik.
3. Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 20 gusht 2026.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës për nxjerrjen e akteve të nevojshme për procedurën e administrimit të dokumentacionit për këtë proces.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

NJOFTIM – SHPALLJE
**“PËR HAPJEN E PROCESIT, PËR SHPREHJEN E INTERESIT, PËR T’U
PËRZGJEDHUR SI KANDIDAT QË DO T’I PROPOZOHET KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, PËR T’U ZGJEDHUR NË POZICIONIN E ANËTARIT TË
KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NË AUTORITETIN E KONKURRENCËS”**

Presidenti i Republikës, pas administrimit të njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë, nr. 2982 prot., datë 3.7.2026, se mandati 5-vjeçar i zonjës Rezana Konomi, si anëtar i Komisionit të Konkurrencës, përfundon në datën 14.10.2026, në mbështetje të nenit 21, pika 3/a, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka vendosur:

Hapjen e procesit për çdo të interesuar, që të shprehë interesin për të qenë kandidat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës, që do të zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë me propozim të Presidentit të Republikës.

Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9121/2003, anëtarët e Komisionit të Konkurrencës zgjidhen nga Kuvendi, me kandidatura të ndryshme, ku një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës. Anëtar i Komisionit të Konkurrencës mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë proces publik e të shprehë interesin për të qenë kandidat për anëtar të Komisionit të Konkurrencës dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës dokumentacionin, si më poshtë:

- kërkesë për shprehjen e interesit;
- jetëshkrim në gjuhën shqipe me të dhënat e plota të kontaktit;
- kopje të noterizuar të dokumentacionit shoqërues që vërteton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për t’u zgjedhur në këtë pozicion, të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;
- c) të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti “E drejtë civile/administrative”;

- d) të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen **me postë** ose **drejtpërdrejt** në mjediset e selisë së Presidentit të Republikës, me adresë: *Institucioni i Presidentit të Republikës, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.*

Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 20 gusht 2026.

Për kandidatin/-ët e përzgjedhur do të kërkohej paraqitja e dokumentacionit shtesë, si më poshtë:

- Formulari i vetëdeklarimit, i plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar. Formulari i vetëdeklarimit është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Formulari i aplikimit i plotësuar “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Ky formular është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Vetëdeklarimi i aplikuesit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit, sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e personave, të cilët kanë shprehur interesin do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe në mjetet e informimit publik.

Propozimi që Presidenti i Republikës do t’i përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

[Formular-Vetëdeklarimi](#)
[Formular – AIDSSH](#)